

V E N D I M
Nr. 579, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E PUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Pukës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Pukës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashklidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2725 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 872 000 (tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Pukës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Pukës.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista emërore e pronarëve që do të shpronësohen për ndërtimin e varrezave, publike te Bashkisë së Pukës

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/ m ²	Vlera në lekë
1	Halil Mus Laçi	1413	320	452160
2	Sherif Osman Laçi	1090	320	348800
3	Hamit Kapllan Laçi	222	320	71040
	Shuma	2725		872 000